



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 264, datë 30.07.2020

**PËR
MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT
PËR GJYQTARIN E GJYKATËS SË APELIT TIRANË, Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 61 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” të ndryshuar, në nenin 65 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pas shqyrtimit të kërkesës për heqjen dorë nga statusi i magjistratit të gjyqtarit {...}, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status.
2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.07.2020.
3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR